



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 7755 Prot.

Roskovec, më 30.08 2022

V E N D I M

Nr. 63, datë 29/08/2022

“ P Ë R P Ë R D O R I M I N E F O N D I T T Ë K U S H T Ë Z U A R T Ë E M E R G J E N C A V E C I V I L E P Ë R V I T I N 2 0 2 2 ”

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, neni 9, pika 1.3 gërma c, neni 54 pika dh, të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjen vendore“ neni 45, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” i ndryshuar neni 44, të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, ligjin nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM nr. 414 datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, VKM nr. 667 datë 10.11.2021 “Për trajtimin e vullnetarëve për angazhimin e tyre në aktivitetet të mbrojtjes civile apo në operacionet e parandalimit e të përballimit të fatkeqësive” të VKB nr.103 datë 24.12.2021 “Për miratimin e buxhetit, numrin maksimal të punonjësve të Bashkisë Roskovec dhe ndërmarjeve vartese për vitin 2022” si dhe materialeve të sjellë nga Drejtoritë përkatëse të Bashkisë; Këshilli i Bashkisë,

V E N D O S I :

- I. Miratimin e përdorimit të fondit të mbetur të emergjencave civile për vitin 2022 si më poshtë vijonë :
1. Të miratohet fondi prej 102,500 lekë për objektin “Tarifa e primit të sigurimit të jetës dhe shëndetit të vullnetarëve që do angazhohen në aktivitete të mbrojtjes civile”
 2. Të miratohet fondi prej 410,000 lekë për objektin “Shpenzime për ushqim për vullnetaret që do angazhohen në aktivitete të mbrojtjes civile”
 3. Të miratohet fondi prej 803,040 lekë për objektin “Shpenzime për veshje dhe pajisje të ndryshme për vullnetarët që do angazhohen në aktivitete të mbrojtjes civile”
 4. Të miratohet fondi prej 3,300,000 lekë për objektin : “Ndërrhyrje emergjente në infrastrukturë për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore”, sipas objekteve të mëposhtme:
 - “Punime për riveshjen e kanalit V-35 dhe portës hyrëse në V3” 84,355 lekë
 - “Punime për pusetën e thithjes së stacionit të pompimit “Hoxhenjtë” 568,644 lekë
 - “Punime për hapjen e rrugës në pyllin e Vloshit” 2,647,001 lekë

GR. 17 TIT. 10910 KAP.01 ART.604

4,615,540 lekë

II . Ngarkohet Nëpunësi Autorizues dhe Drejtoria Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi.

III.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R

Kadri Hyska

